



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 15 janar 2013**

**Numri i lëndës: 2012-08**

**Mufail Halili**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 14 dhe 15 janar 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit më 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 29 qershor 2012.

## II. FAKTET

2. Faktet e lëndës, ashtu siç janë parashtruar nga parashtruesi i ankesës, mund të përmbliidhen si në vijim.

### *Procedura penale kundër parashtruesit të ankesës*

3. Më 11 mars 2009, prokurori i qarkut i Prizrenit akuzoi parashtruesin e ankesës për vrasjen e bashkëshortes së tij L.H. dhe të kunatit të tij H.S.
4. Më 2 qershor 2010, Gjykata e Qarkut e Prizrenit, e mbledhur në një trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, shpalli fajtor parashtruesin e ankesës sipas akuzës dhe e dënoi atë me tridhjetë vjet burgim.
5. Më 9 qershor 2011, një trup gjykues i Gjykatës Supreme i përbërë nga pesë gjyqtarë hodhi poshtë ankesat e paraqitura nga prokurori publik i qarkut, familjet e viktimave dhe parashtruesi i ankesës dhe mbështeti aktgjykimin e shkallës së parë.
6. Në bazë të një ankese pasuese të paraqitur nga prokurori publik i qarkut dhe familjet e viktimave, më 15 mars 2012, Gjykata Supreme e mbledhur në një trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë ndryshoi aktgjykimin e saj të mëparshëm dhe e dënoi parashtruesin e ankesës me dyzet vjet burgim. Ankesa e parashtruesit u hodh poshtë.

### *Kujdestaria e fëmijëve të parashtruesit të ankesës*

7. Parashtruesi i ankesës pohon që është baba biologjik i shtatë fëmijëve, dy prej tyre (S.H. dhe A.H.) me bashkëshorten e ndjerë, dhe është baba birësues i vajzës së saj. Duket që para vdekjes së bashkëshortes së parashtruesit të ankesës, A.H. dhe katër fëmijët e tjerë të parashtruesit të ankesës nga martesë e parë jetonin me të, ndërsa S.H. jetonte me nënën e saj. Nuk është e qartë kush e kishte kujdestarinë për fëmijët e tjerë.
8. Më 28 tetor 2008, Gjykata Komunale në Prizren ia dha kujdestarinë për A.H. bashkëshortes së parashtruesit të ankesës, L.H. Pas vdekjes së L.H. dhe arrestimit të parashtruesit të ankesës, A.H. u vendos në një strehimore në Prishtinë. Parashtruesi i ankesës pohon që gruaja e tij e parë i mori katër fëmijët e tjerë që të jetojnë me të në Shqipëri. Ai thotë që ata jetojnë në kushte shumë të këqija dhe që nëna e tyre nuk është në gjendje të kujdeset për ta si duhet. Parashtruesi i ankesës po ashtu pohon që ai ka kërkuar nga shumë institucione të Kosovës, përfshirë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Avokatin e Popullit dhe Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut që t'i ndihmojnë atij t'i kthejë fëmijët në Kosovë dhe t'iu ofrojnë atyre kujdes institucional, por nuk kishte kurrfarë suksesi.

### *Keqtrajtimi i pretenduar në burg*

9. Në një datë të pacaktuar parashtruesi i ankesës është arrestuar dhe është dërguar në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Ai pohon që

është keqtrajtuar nga të arrestuarit e tjerë dhe personeli. Më 1 maj 2009, ai është transferuar në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

10. Pas shpalljes së tij fajtor më 5 maj 2010, më 31 korrik 2010 parashtruesi i ankesës u vendos përsëri në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Ai pohon që përsëri është gojarisht nga personeli dhe të burgosurit e tjerë. Parashtruesi i ankesës po ashtu thotë që kushtet e jetesës në burgun e Dubravës ishin shumë të këqija.
11. Më 3 shtator 2009, parashtruesi i ankesës u transferua në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, ku, siç pohon ai, u keqtrajtua vazhdimisht gojarisht nga njëri prej rojeve të burgut.
12. Më 1 tetor 2011, parashtruesi i ankesës u transferua në burgun e Lipjanit dhe pastaj përsëri në Dubravë. Ai ankohet që deri sa ishte në Dubrava u keqtrajtua nga një kujdestar por nuk dha hollësi.
13. Më 25 maj 2012, parashtruesi i ankesës u zhvendos në Qendrën e Paraburgimit në Pejë. Ai pohon që i është nënshtruar regjimit të të paraburgosurve, edhe pse tashmë ishte i dënuar. Ai ankohet që ishte detyruar t'i kalojë njëzet e dy orë e gjysmë në ditë në qelinë e tij me të burgosurit e tjerë dhe ishte lejuar ta bëjë një thirrje telefonike prej pesëmbëdhjetë minutash në javë, i monitoruar nga roja e burgut. Në një datë të pacaktuar parashtruesi i ankesës ishte transferuar përsëri në burgun e Dubravës.
14. Parashtruesi i ankesës kishte dërguar shumë ankesa tek institucionet e ndryshme, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Shefit të Komponentës të Drejtësisë të EULEX-it, Avokatit të Popullit, Kryetarit të Kosovës në të cilat ishte ankuar për shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij. Ai po ashtu thotë që ka ngritur padi penale tek Kryeprokurori i EULEX-it. Nuk janë ofruar kurrfarë hollësi ose dokumente përkatëse.

### III. ANKESAT

15. Parashtruesi i ankesës pretendon se është fajësuar pa të drejtë dhe kërkon rigjykim.
16. Më tej ai ankohet që autoritetet nuk ju kanë ofruar mbrojtje katër fëmijëve të tij. Ai i referohet Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës.
17. Parashtruesi i ankesës po ashtu i referohet Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor apo Poshtëruar (Konventa kundër Torturës) dhe pohon se në burg i është nënshtruar torturës psikologjike dhe ankohet për kushtet e këqija të jetesës në burgjet dhe në qendrat e paraburgimit të Kosovës.

#### IV. LIGJI

18. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
19. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorin e drejtësisë, të policisë dhe të doganës.
- Padrejtësia e procedurës penale kundër parashtresit të ankesës*
20. Paneli konstaton se ankesa e parashtresit në thelb ka të bëjë me rezultatin e procedurës gjyqësore kundër tij dhe gjoja dënimit të tij të padrejtë.
21. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së punës, bazuar në konceptin e përgjegjësisë në OPLAN e EULEX-it në Kosovë, mandati i Panelit nuk e autorizon atë t'i shqyrtojë as aspektet administrative as ato gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Ato janë kompetencë vetëm e gjykatave të Kosovës (shih, për shembull, lëndët e PSHDNJ nos 2012-03, *Dobruna kundër EULEX-it*, § 12, dhe 2011-06, 2012-05, *Pajaziti kundër EULEX-it*, § 9). Kundër vendimeve të gjykatave të Kosovës mund të ushtrohen ankesa dhe sipas ligjit të zbatueshëm janë në dispozicion mjetet ndihmëse të jashtëzakonshme juridike (shih, në mes tjerash, lënda e PSHDNJ nr. 2011-01, *Dedë Gecaj kundër EULEX-it*, § 51).
22. Sidoqoftë, Paneli konstaton se parashtresat e parashtresit të ankesës nuk zbulojnë ndonjë shfaqje të padrejtësisë së procedurës në fjalë. Kur e kundërshton drejtësinë e procedurës gjyqësore, parashtresi i ankesës nuk nxjerrë si shkak ndonjë të metë specifike procedurale në lidhje me të drejtën e tij për gjykim të drejtë nga ana e autoriteteve gjyqësore. Ankesat e tij kufizohen në kundërshtimin e përmbajtjes së vendimeve të nxjerra nga këto autoritete në rastin e tij dhe lajthimin mbi faktet dhe ligjin gjoja të kryera nga ato. Në thelb ai kundërshton rezultatin e procedurës penale kundër tij.
- Kujdestaria e fëmijëve të parashtresit të ankesës*
23. Sa i përket ankesës lidhur me gjendjen e fëmijëve të parashtresit të ankesës nga martesë e parë, Paneli konstaton që mandati i përgjithshëm ekzekutiv i EULEX-it nuk i përfshin aktivitetet e karakterit gjyqësor apo administrativ që kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijëve dhe mirëqenien sociale. Prandaj, çështjet e ngritura nga parashtresi i ankesës nuk bëjnë pjesë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe, për rrjedhojë, nuk bëjnë pjesë në mandatin e Panelit, ashtu siç thuhet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe në OPLAN të EULEX-it në Kosovë. Sidoqoftë, edhe nëse supozojmë që parashtresi i ankesës e bind Panelin që gëzon autoritet formal për të vepruar në emër të fëmijëve të tij, në

Panel nuk janë dorëzuar kurrfarë argumentesh bindëse për ta bindur atë që në rrethanat e këtij rasti interesi më i mirë i fëmijëve do të ishte që ata të merren nga përkujdesja e familjes së tyre dhe të vendosen në përkujdesje institucionale.

24. *Keqtrajtimi i pretenduar në burgje dhe në qendra të paraburgimit*  
Parashtruesi i ankesës po ashtu pohon që në burg i është nënshtruar torturës psikologjike që përbën shkelje të Konventës mbi Torturën. Ankesa po ashtu duhet të shqyrtohet sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa Evropiane) e cila thotë si vijon:

### **Neni 3**

#### **Ndalimi i torturës**

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

25. Së pari Paneli vëren që ai mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat e parashtruara gjashtë muaj para datës së shkeljes së pretenduar ashtu siç parashihet në rregullën 25, paragrafi 3, i rregullores së punës. Gjatë shqyrtimit të kësaj pjese të kësaj ankese, Paneli nuk do ta marrë parasysh asnjë shkelje të pretenduar të të drejtave të parashtruesit të ankesës të cilat kanë mundur të ndodhin para datës 30 dhjetor 2011.
26. Për aq sa mund të thuhet parashtruesi i ankesës ndërlidhet me ngjarjet që kanë ndodhur pas kësaj date, Paneli konstaton që në këtë rast nuk është argumentuar, lëre më të dëshmohet, që EULEX-i ka qenë në ndonjë mënyrë i përfshirë në shkeljet e pretenduara.
27. Në çdo rast, Paneli më tej konstaton që keqtrajtimi duhet ta arrijë nivelin minimal të ashpërsisë për të hyrë në sferën e nenit 3 (KEDNJ, aktgjykimi Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar i datës 18 janar 1978, Seria A, nr. 25, faqe 65, § 162, ose, në mesin e shumë autoriteteve të tjera, *Iwanczuk kundër Polonisë*, nr. 25196/94, § 50, 15 nëntor 2001). Më tej përsërit që, sipas domethënies të Konventës kundër Torturës "shprehja "torturë" nënkupton çdo akt me anë të secilit një personi i shkaktohet qëllimisht dhimbje e madhe ose vuajtje, si fizike ashtu edhe mendore" (neni 1). Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut tortura nënkupton "trajtim të qëllimshëm çnjerëzor duke shkaktuar vuajtje shumë të rënda dhe mizore" (shih, në mesin e shumë autoriteteve të tjera *Selmouni kundër Francës* [GC], nr. 25803/94, § 96, KEDNJ 1999-V). Ngjashëm, neni 165 i KPPK përkufizon torturën si "cilido akt ose pavëmendje me anë të të cilit një personi i shkaktohet qëllimisht dhimbje ose vuajtje e madhe, si fizike ashtu edhe mendore". Megjithatë, Paneli konstaton që parashtruesi i ankesës nuk jep ndonjë hollësi që do t'ia mundësonte të vijë në përfundim që trajtimi që i është bërë atij ka qenë trajtim çnjerëzor apo poshtërues sipas nenit 3 të Konventës Evropiane, e lëre më që ka qenë torturë sipas dispozitës së njëjtë ose sipas nenit 1 të Konventës kundër Torturës, ose nenit 165 të KPPK.

28. Më tej Paneli vëren që obligimi procedural për EULEX-in që t'i hetojë shkeljet e pretenduara të nenit 3 të Konventës mund paraqitet në rrethana të caktuara. Domethënë, neni 3.3 i Ligjit nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji për Juridiksionin) rendit veprat penale të cilat janë kompetencë e prokurorëve të EULEX-it, në mesin e tyre edhe tortura (ashtu si përkufizohet në nenin 165 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK)). Paneli përsëritë që, sipas nenit 12 të Ligjit mbi Juridiksionin, prokurorët e EULEX-it kanë kompetenca ta marrin përsipër një hetim apo ndjekje të veprave penale, në rast se prokurorët e Kosovës nuk dëshirojnë apo nuk mundën t'i kryejnë detyrat e tyre dhe kjo mosdashje ose pamundësi e tyre mund ta rrezikojë hetimin ose ndjekjen e duhur penale. Në mënyrë që të paraqitet kjo mundësi, megjithatë, së pari lënda duhet t'i referohet një prokurori publik vendas. Nëse pastaj prokurori publik vendas nuk dëshiron ose nuk mundet të merret me rastin, parashtruesi i ankesës do të mund ta njoftonte Kryeprokurorin e EULEX-it, i cili pastaj do të vendoste nëse do t'ia caktojë lëndën ndonjë prokurori tjetër publik të Kosovës ose ndonjë prokurori të EULEX-it. Paneli konstaton që parashtruesi i ankesës nuk ka treguar që i ka paraqitur ankesat e tij tek autoritetet kosovare të ndjekjes penale.
29. Prandaj kjo ankesë nuk bën pjesë në mandatin ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe, për rrjedhojë, nuk bën pjesë as në mandatin e Panelit, ashtu siç është formuluar në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe në OPLAN të EULEX-it në Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konsideron se ai nuk ka kompetenca ta shqyrtojë ankesën dhe konstaton që ankesa është dukshëm e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese